



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 19. 11.2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë anëtarët e Komisionit: Suzan Novoberdali, kryetare, Rita Hajzeraj -Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Kymete Bajraktari, Albana Gashi, Kimete Bytyçi dhe Duda Balje.

Mungoi: Justina Shiroka - Pula .

Stafi mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, zyrtar i lartë ligjor, Sulltane Gashi, zyrtare ligjore dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit.

Të ftuar: Sami Kurteshi, Avokat i Popullit dhe Bogoljub Staletoviq, zëvendësavokat i Popullit.

Pjesëmarrësit e tjerë: Visar Bivolaku-EUSR/EUO, Edona Tolaj-YIHR-Kosova, Nuredin Ibishi -UNDP, Lejla Selimi-OSBE, Ukë Gashi-ZPRK, Fehmi Pireva-Kuvendi i Kosovës, Adem Breznica-Kosova live, Marije Nikolla-TV Rrokum, Lumturije Beha-KOSOVA Info, Liridon Xhemajli-RTV 21, Mejreme Tahirukaj-Radio Kosova, Elvin Sefiu-Kosova Press, Shkumbin Asllani-CRDP dhe Gurjeta Zeka-Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali, kryetare e Komisionit.
Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 nëntor 2013;

3. Rishqyrtimi i Raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i dytë i Udhëzuesit për Mënyrën e Procedimit të Peticioneve;
5. Shqyrtimi i Peticioneve;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës,

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime, por kryetarja tha se deri sa të vinë në mbledhje palët e ftuara, po fillojmë me shqyrtimin e pikave të tjera të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 nëntor 2013;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur me 12 nëntor u miratua pa vërejtje.

5. Shqyrtimi i peticioneve;

Rita Hajzeraj-Beqaj, i njoftoi anëtarët e Komisionit se janë dy peticione për shqyrtim. Lidhur me petitionin e parë që ka të bëjë me Z. Staletoviq, zëvendësavokatit të Popullit, ajo tha se do të shqyrtohet pasi që të vijë Avokati i Popullit dhe zëvendësi i Avokatit të Popullit. Sa i përket petitionit, të dytë, ajo tha se ka mbetur që nga grupi nga Komisioni të shkojë në Prizren tek qendrat parashkollore dhe ta verifikojë gjendjen.

Në vazhdim, ajo i njoftoi me përmbajtjen e këtij petitioni. Duke u ndërlidhur ajo tha se në fillim këto dy qendra parashkollore janë financuar nga Karitasi dhe në një marrëveshje që e kanë bërë Drejtoria e Arsimit dhe Karitasi, janë dakorduar që pas skadimit të kontratës me Karitasin, financimin e personelit punonjës ta bëjë Drejtoria e Arsimit të Komunës së Prizrenit. Në bazë të deklaratave të punëtorëve të këtyre qendrave dhe Karitasit, thuhet se marrëveshja nuk është respektuar dhe financimi i personelit të këtyre qendrave nuk po bëhet nga autoritetet komunale të Prizrenit. Ajo ishte e mendimit që duhet të vizitohen qendrat parashkollore por edhe Drejtoria e Arsimit në Komunën e Prizrenit, në mënyrë që të vërtetohet situata e krijuar.

Kymete Bajraktari, duke u ndërlidhur me petitionin, theksoi se ajo ka fakte se ekziston marrëveshja ndërmjet Drejtorisë së Arsimit dhe Karitasit, që pas skadimit të programit të Karitasit këtë financim ta bëjë drejtoria. Këto fakte, ajo tha se gjenden në materialin që e kanë dorëzuar punëtorët e këtyre qendrave parashkollore. Ajo ishte e mendimit të njëjtë me parafolësen që të vizitohen qendrat parashkollore si dhe Drejtoria e Arsimit në Komunën e Prizrenit.

Kryetarja, theksoi se lidhur me këtë kërkesë, duhet të caktohet një datë në të cilën do të vizitohen qendrat parashkollore dhe Drejtoria e Arsimit të Komunës së Prizrenit.

4 Shqyrtimi i dytë i Udhëzuesit për Mënyrën e Procedimit të Peticioneve;

Rita Hajzeraj -Beqaj, tha se grupi i punës ka punuar në hartimin e Udhëzuesit për hartimin e peticioneve me ç’rast janë ndihmuar edhe nga NDI- ja, mirëpo ajo konstatoi se ky udhëzues ka nevojë që të plotësohet dhe të ndryshohet, në mënyrë që udhëzuesi të jetë sa më i kompletuar në mënyrë që mos të kenë probleme në të ardhmen lidhur me këtë çështje.

Në vazhdim, ajo tha se në bazë të Rregullores së Kuvendit, Komisionit i lejohet që të hartojë rregulla të brendshme dhe për këtë arsye ata kanë vendosur që të hartohet një udhëzues që do tu shërbejë qytetarëve dhe Komisionit.

Lidhur me procedurat e mëtutjeshme për këtë çështje, ajo tha se në afat prej një muaji të analizohet nga anëtarët e tjerë dhe të paraqiten propozimet e tyre për plotësimin e këtij udhëzuesi, me qëllim që ai të jetë sa më i kompletuar.

Kryetarja, theksoi se kanë kërkuar që projektudhëzuesin ta kenë disa ditë më herët anëtarët e Komisionit, në mënyrë që të mund të paraqesin qëndrimet e tyre lidhur me këtë. Lidhur me përmbajtjen e Udhëzuesit, ajo tha se është pak e komplikuar sepse nuk janë të precizuara rastet kur qytetarët nuk mund të paraqesin kërkesa në Kuvend.

Në vazhdim, ajo tha se janë procedurat e komplikua për shkak se duhet të përdoren formularët si dhe të dërgohen kërkesat, në mënyrë elektronike dhe lidhur me këtë, ajo tha se disa gjëra po komplikohen sepse duhet të vërtetohet personi që e ka dërguar kërkesën, në mënyrë elektronike. Udhëzuesi, tha, duhet të reduktohet nga nenet, në mënyrë që të jetë më i thjeshtë për qytetarin.

Biserka Kostiq, theksoi se e ka shqyrtuar projektudhëzuesin. Ajo në vazhdim tha se në rregullën dy thuhet se secili qytetarë ka të drejtë të parashtojë petitionin në njërin nga gjuhët zyrtare në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ajo tha se me Kushtetutë është paraparë, që secili ta parashtojë petitionin në gjuhën e tij por duhet shkruar në udhëzues se kush është kompetent për përkthimin e peticioneve sepse në rast se peticioni është në shqip, duhet të përkthehet në gjuhën serbe ose në rastet kur petitionet janë në gjuhën serbe, duhet të përkthehen në gjuhën shqipe. Ajo ishte e pajtimt që parimisht të përkrahet projektudhëzuesi, por ai duhet të modelohet, në mënyrë që të gjendet mënyra që të përkthehen petitionet, pasi që sipas saj po ka paqartësi rreth përkthimit të peticioneve sepse shërbimi i përkthimit në Kuvend, nuk është kompetent për përkthimin e këtyre peticioneve, prandaj ajo kërkoi që kjo çështje të rregullohet në këtë projektudhëzues.

Albana Gashi, ishte e mendimit të njëjtë me anëtarët e tjerë, që ky projektudhëzues të thjeshtësohet sepse duhet të jetë sa më i lehtë për qytetarët dhe t’iui mundësohet qasja të gjithë qytetarëve sepse në këtë gjendje ky projektudhëzues nuk i lejon qasje të gjithë qytetarëve sepse nga kërkesat e paraqitura deri më tani, mund të konstatohet se ato shumë herë kanë qenë të adresuara gabimisht dhe kanë pasur gabime në shkrim dhe se mënyra e përpilimit të formularëve në këtë projektudhëzues, e përjashton këtë kategori të qytetarëve.

Gashi ishte e mendimit që nëse nuk ju mundësohet qasja të gjithë qytetarëve me veprime të tilla bëhet shkelje e të drejtave të tyre për paraqitjen e kërkesave dhe ankesave të tyre.

Rita Hajzeraj – Beqaj, propozoi që të mbahet një punëtori lidhur me këtë projektudhëzues dhe të gjithë anëtarët e Komisionit të paraqesin mendimet e tyre dhe të kompletohet ky projektudhëzues .

Kurtan Kajtazi, lidhur me projektudhëzuesin, tha se kanë punuar një kohë të gjatë në mënyrë që të thjeshtësohen procedurat. Sa i përket formularëve të projektudhëzuesit, ai tha se është shumë i qartë dhe shumë i thjeshtë

Pas një debati lidhur me këtë projektudhëzues, u vendos që të organizohet një punëtori në të ardhmen, në mënyrë që të përpunohet dhe të miratohet projektudhëzuesi.

Kryetarja, lidhur me kërkesën e zëvendësavokatit të Popullit, tha se i kanë ftuar të dy palët me qëllim të sqarimit dhe jo të mbikëqyrjes së organizimit të brendshëm sepse nuk është kompetencë e Komisionit mbikëqyrja e organizimit të brendshëm të këtij institucioni.

Në fund, ajo tha se ky takim është bërë me qëllim të ndihmesës në këtë çështje dhe nuk ka kurrfarë qëllimi tjetër.

Bogolub Staletoviq, i njoftoi anëtarët e Komisionit se është zv. avokati i Popullit, i cili është i ngarkuar me fushën e diskriminimit në këtë institucion. Lidhur me paraqitjen e ankesës, ai tha se ka ardhur me qëllim që ti paraqet shqetësimet e tij dhe t'i bind me vërtetësinë e tyre.

Ai në vazhdim tha se në fillim të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit, është përballur me vështirësi të natyrave të ndryshme, e një ndër to ka qenë përkthimi që kanë tentuar të orientojnë në parametrat e tij të punës, në kuptim të dëgjueshmërisë dhe mosreagimit të gjërave, të cilat i vëren në institucion. Ai tha se qëllimi i tij ka qenë që të jetë aktiv për të drejtat e të gjithë njerëzve në Kosovë. Ai theksoi se në fillim janë përballur me vështirësi të mëdha, duke precizuar mungesën e të ardhurave të punonjësve në IAP-it, më konkretisht zëvendësit të Avokatit të Popullit dhe përkundër këtij fakti, ata janë marrë me zgjidhjen e çështjeve, që janë paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit. Ai tha se mospajtimet kanë filluar në kohën kur ka paraqitur shkresë tek Avokati i Popullit dhe drejtori ekzekutiv, duke shtuar se është urdhëruar nga Avokati i Popullit që mos ti drejtohet me shkresë, por për çdo gjë që ka shqetësime, të bisedojnë gjë që nuk e ka pranuar këtë sepse ka dëshiruar që të mbesin fakte me shkrim komunikimi për çështje të tilla.

Si raste që ai paraqiti ishte rasti i arrestimit të disa qytetarëve në Anamoravë, ku ka kërkuar ti vizitojë familjet e të arrestuarve dhe personat e arrestuar. Lidhur me këtë, ai tha se nuk ka marrë leje nga Avokati i Popullit dhe nuk e ka kuptuar pse nuk mund ti vizitojë njëkohësisht të arrestuarit dhe familjet e tyre, këtë ai e ka paraqitur si pakënaqësinë e parë ndërmjet tyre. Lidhur me këtë rast, ai tha se Avokati i Popullit ka shfaqur pakënaqësinë e tij dhe ky nuk ka dashur të reagojë për atë mënyrë të reagimit dhe ai është penguar që ti vizitojë të arrestuarit. Në vazhdim duke e theksuar diskriminimin ndaj tij, i theksoi vizitat jashtë vendit ku sipas një shkrese që ai posedon tha se më së paku ka marrë pjesë në vizitat jashtë vendit. Lidhur me këto vizita, ai tha se asistentja shkon 10 herë më shumë se ai në vizita jashtë vendit dhe zëvendësit e tjerë.

Ai kishte vërejtje edhe në joprofesionalizmin dhe pasivitetin e administratës dhe në këtë mënyrë nuk paraqiten raportet tek zëvendësit, për ti njoftuar me ngjarjet në institucion. Ai tha se ka tentuar ti ndihmoj drejtorit ekzekutiv me qëllim të përmirësimit të situatës. Nga ai ka kërkuar listën e trajnimeve, në mënyrë që të bëhet një paralele ndaj të gjithë zyrtarëve të këtij institucioni. Ai tha se është çështje me rëndësi që të hulumtohet se kush e udhëheq buxhetin në këtë institucion dhe asnjëherë nuk ka marrë informacionet që ka kërkuar lidhur me këtë çështje, me arsyetimin se unë jam në sektorin kundër diskriminimit.

Ai tha se në institucion ka nëpunës që paguhën për kryerjen e aktiviteteve të tjera dhe ka veprime jo logjike. Duke u ndërlidhur me qasjen në dokumentet zyrtare, ai tha se ata mund të kenë qasje

në institucionet e tjera dhe t'i marrin kopjet e dokumenteve që ia garanton ligji, mirëpo këtë gjë ai tha se nuk mund ta bëjë në institucionin e Avokatit të Popullit. Edhe pse ka kërkuar dokumentet e tilla në IAP, nuk i ka marrë asnjëherë dhe në këtë mënyrë nuk ka mundur ti vërtetojë dyshimet që i ka pasur lidhur me parregullsitë në Institucion dhe në vazhdimësi është refuzuar kërkesa e tij nga zyrtari për qasje në dokumente publike. Lidhur me materialin e paraqitur në lëndën e tij, ai tha se të gjitha materialet janë të argumentuara, dhe për çështje të tilla, ai disa here ka kërkuar sqarime se pse ky është në planin e dytë, mirëpo nuk ka marrë përgjigje. Sa i përket rastit të z. Arsim Agani, ai tha se ka qenë drejtor i Administratës, të cilit nuk i është vazhduar kontrata e punës dhe për këtë rast ka pasur diskutime në kolegjum dhe ka kërkuar sqarime se cilat janë mënyrat që qetësisht të zgjidhet kjo punë nga vetë institucioni, mirëpo argumentet të cilat i ka prezantuar z. Jashari, nuk kanë qenë adekuate dhe po i njëjti ka thënë se nuk duhet të përzihen në punët e administratës. Ai e potencoi edhe një fakt sipas të cilit vendimi për kthimin në punë të ish- drejtorit Arsim Agani, asnjëherë nuk i është dorëzuar zv. avokatit të Popullit z. Bogolub Staletoviq dhe për këtë rast, ai tha se janë përdorur standarde të dyfishta. Lidhur me këtë çështje ai tha se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, ka refuzuar të gjitha faktet e paraqitura nga ana e institucionit dhe në këtë rast ka marrë vendim që z. Agani të kthehet në punë, por ai nuk e di se pse vendimi i tillë nuk është zbatuar nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit. Në vazhdim, ai tha se ka dhënë mendimin e tij se nuk pajtohet me këtë çështje, ku vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nuk zbatohet me ç' rast do të kthehej në punë z. Agani sepse qëllimi i Avokatit të Popullit duhet të jetë mbrojtja e të drejtave të gjithë qytetarëve e jo sipas dëshirës së Avokatit të Popullit.

Ai përmendi edhe një ankesë tjetër, e cila ka të bëjë me një shkresë që e ka dërguar asistentja ne gjuhën shqipe, ndërsa ai ka kërkuar që të respektohet dygjuhësia dhe materialet ti dërgohen në të dy gjuhët. Pas kësaj ai tha se është fyer dhe kërcënuar se kinse po bën presion ndaj saj. Për këtë çështje ai tha se i ka dërguar njoftimin z. Jasharit, zëvendësve të Avokatit të Popullit si dhe Avokatit të Popullit dhe në këtë mënyrë kanë qenë të gjithë të njoftuar me ngjarjen në Institucion.

Sa i përket vizitave jashtë vendit, ai e përmendi rastin e një vizite, ku ka qenë në plan që të shkojë edhe ai dhe për këtë është njoftuar 17 ditë para ditës së vizitës, pastaj ai tha se si ka ndodhur ngjarja nuk e din, por ai është eliminuar dhe nuk ka mundur që të shkojë në këtë vizitë. Në vazhdim, ai tha se atij nuk i lejohet që ta përdorë veturën kurse Avokati i Popullit e përdorë këtë edhe kur është në pushim vjetor. Veturën po ashtu e shfrytëzon vozitësi i tij nga puna në shtëpi. Sa i përket përpilimit të raporteve, ai tha se ka qenë deri në këtë vit i ngarkuar që të raportojë për çështjen e zgjedhjeve kurse këtë vit ai e ka angazhuar një zëvendës tjetër që të merret me këtë çështje.

Në fund, ai tha se nuk dëshiron që kjo ankesë të ndikojë në raportet mes kolegëve në këtë institucion sepse sipas mendimit të tij, ai dëshiron që të ketë raporte të mira me të gjithë anëtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Biserka Kostiq, duke u ndërlidhur me lëndën e z. Staletoviq, tha se ai ka paraqitur edhe në fusnota faktet, duke argumentuar rastet kur janë shkelur të drejtat e tij nga institucioni, i cili është i obliguar të mbroje të drejtat e qytetarëve, pavarësisht nga përkatësia nacionale, ngjyra apo përkatësia fetare e jo ti shkel ato. Ajo pyeti z. Staletoviq se a e konsideron ai se tani është rrezikuar pozita e tij nga faktet që janë paraqitur në këtë ankesë para Komisionit për të Drejtat e Njeriut.

Në vazhdim ajo u ndërlidh me takimin e kaluar, ku ajo tha se gjatë bisedës me Avokatin e Popullit ka marrë epitelin e racistes dhe për këtë ajo ishte e mendimit se Avokati i Popullit duhet të kërkoj falje sepse në kontekstin e bisedës nuk ka pasur fare të bëjë me racizmin. Lidhur me këtë rast, ajo tha se nëse Avokati i Popullit e shikon me këtë pikëpamje, vetëm pse ajo është e komunitetit serb, atëherë ajo tha se nuk do të jetë pjesë e Kuvendit.

Bogolub Staletoviq, duke u ndërlidhur me pyetjen e anëtares së Komisionit, tha se është ndjenjë jo e mirë dhe ka frikë. Ai në vazhdim i njoftoi se kur ka reaguar për shkak të shkresës së asistentes, e cila nuk ka qenë në gjuhën serbe, asnjë nga zëvendësit e Avokatit të Popullit nuk ka reaguar dhe në këtë mënyrë kanë shkaktuar dilema tek z. Staletoviq, i cili konsideron se është diskriminim i drejtpërdrejtë dhe për këtë tha se është i sigurt.

Sami Kurteshi, fillimisht pyeti se dokumentin që e kanë marrë, a është dokument zyrtar dhe në cilën gjuhë është dorëzuar në Komision. Në vazhdim, ai theksoi se z. Staletoviq është njëri nga pesë zëvendësit e Avokatit të Popullit që janë emëruar tash dy vite.

Sa i përket pyetjeve që i janë drejtuar atij, i tha se prej kohës kur z. Staletoviq është emëruar zëvendësavokat i Populli, nuk ka asnjë shkresë profesionale që e ka bërë z. Staletoviq në fushën ku është caktuar. Ai tha se asnjë punim profesional nuk e ka gjatë tërë kësaj periudhe.

Në vazhdim ai e njoftoi Komisionin se z. Staletoviq e ka hapur një rast ex –officio për fshatarët e disa fshatrave të rrethit të Graçanicës për mungesë të ujit para tetë muajve dhe pastaj asnjë veprim tjetër nuk e ka bërë lidhur me këtë rast. Ai po ashtu ngriti dyshimet e tij se z. Staletoviq nuk ka kualifikimet e duhura për ta ushtruar këtë profesion. Lidhur me këtë rast, z. Kurteshi kërkoi nga Komisioni që ta bëjë verifikimin e dokumenteve të përgatitjes profesionale të ofruara nga z. Staletoviq. Ai po ashtu i njoftoi se vitin e kaluar kur e ka angazhuar z. Staletoviq për ta paraqitur gjendjen e KQZ –së, me qëllim të paraqitjes në raportin vjetor të punës, ka marrë vërejtje nga punonjësit e KQZ-së për joprofesionalizmin e treguar nga zëvendësi i avokatit të popullit dhe këtë vit ai tha se e ka angazhuar z. Basri Berisha, për të hulumtuar dhe për ta paraqitur në Raportin vjetor të punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, gjendjen e KQZ-së. Avokati i Popullit i informoi Komisionin se menjëherë pas emërimit të zëvendësve të tij, ai e ka emëruar si udhëheqës i parë z. Staletoviq dhe e ka angazhuar në fushën e diskriminimit, që sipas mendimit të tij është fusha kryesore. Këtë ai tha se e ka bërë me qëllim të ofrimit, në mënyrë që ai mos ta ndiej veten të diskriminuar. Ai gjithashtu njoftoi se z. Staletoviq është i vetmi zëvendës, të cilit i është lejuar vetura, të cilën ai e ka shfrytëzuar dhe e ka keqpërdorur.

Sa i përket pohimit të z. Staletoviq, i cili tha se Avokati i Popullit e merr veturën edhe në pushim, ai tha se Avokati i Popullit kur ka punë për të kryer e shfrytëzon veturën, mirëpo gjatë ditëve të pushimit ai nuk e angazhon shoferin sepse angazhimi i tillë kushton dhe për këtë arsye ai nuk e angazhon. Lidhur me këtë çështje, ai tha se gjatë vitit të kaluar Avokati i Popullit nuk e ka bërë asnjë ditë pushimi, për shkak të angazhimit me punët e institucionit. Lidhur me çështjen e ngritur për vizitën e të burgosurve serbë në Burgun e Gjilanit nga Parteshi, ai tha se e ka një grup njerëzisht që janë relativisht të mirë në vizita nëpër të gjitha vendet ku personave iu kufizohet liria. Kurteshi tha se e ka lejuar z. Staletoviq për ti vizituar të burgosurit, mirëpo, nuk e ka lejuar që të vizitohen edhe anëtarët e familjes dhe të burgosurit sepse Institucioni i Avokatit të Popullit e ka të ndaluar që të përcjell porosi e as të bëjë pyetje sugjестive, të cilat siç tha ai, i ka përdorur gjatë kësaj vizite z. Staletoviq.

Kurteshi në vazhdim theksoi se anëtarët e IAP-së për çdo lëvizje duhet të bëjnë raport kurse z. Staletoviq nuk bënë fare raport dhe është jo i saktë në orarin e punës sepse siç tha ai, prej kohës së emërimit e deri me tani asnjëherë nuk ka ardhur në kohën e duhur në punë.

Sa i përket përpilimit të shkresave profesionale, ai tha se i ndihmojnë të tjerët, duke e precizuar z. Isa Hasani, i cili shpesh herë i ka ndihmuar ti përpilojë shkresat sepse sipas tij, ky nuk ka njohuri profesionale ti përgatitë ato.

Lidhur me trajtimin e z. Staletoviq, Avokati i Popullit tha se ai është diskriminuar pozitivisht sepse ato që i janë lejuar atij nuk i janë lejuar asnjë punëtori tjetër në IAP-it. Rreth pohimeve të z. Staletoviq, i cili ka thënë se Avokati i Popullit ka tentuar ta fusë në binarët e tij, ai tha se asnjëherë nuk i është përzier në punë, duke tentuar që mos ta pengojë në punë, mirëpo, ai nuk ka pasur fare aktivitete, dhe sjelljet që duhet të jenë në pajtim me ligjin dhe rregulloren e brendshme, tash e tutje nuk do tolerohen sikur me parë dhe do të trajtohen të gjithë në mënyrë të njëjtë.

Sa i përket gjendjes së z. Staletoviq, ai tha se ai ka dalë jashtë për shkak të pasivitetit të tij sepse dinamika në këtë institucion është shumë e madhe dhe mospuna i nxjerr jashtë personat e tillë. Ai tha se z. Staletoviq nuk e ka fyer dhe nuk e ka kërcënuar askush.

Lidhur me vërejtjen e tij për mospagesën e të ardhurave, ai u shpreh se ky ka qenë problem për të gjithë institucionin dhe nuk është varur nga drejtori ekzekutiv.

Në vazhdim, ai duke u përgjigjur në vërejtjet e bëra nga z. Staletoviq theksoi se nuk e ka urdhëruar atë që mos të shkruaj, por çështjet ti zgjidhë më gojë, por e ka urdhëruar që të jetë më profesional në shkresat e tij. Duke theksuar joprofesionalizmin e z. Staletoviq, ai tha se pjesa e diskriminimit që është dashur të jetë në raportin vjetor të punës mungon, për shkak se z. Staletoviq ka qenë i obliguar ta paraqet gjendjen, mirëpo, ai nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Sa i përket vërejtjeve të cilat kanë të bëjnë me pengesat në udhëtime jashtë shtetit, ai tha se z. Staletoviq nuk e flet asnjë gjuhë të huaj dhe në udhëtime ka shkuar sikur të gjithë të tjerët dhe sa herë që shkon në vizita të tilla, atij i duhet një përkthyes. Ai i informoi se çdo shtet ku ai mund të komunikojë në gjuhën serbe është caktuar që të shkojë në vizita. Duke u ndërlidhur me vizitat, ai tha se në dy vizitat e fundit që janë bërë, njëra në Ohër dhe tjetra në Irlandë, ai edhe pse ka qenë i caktuar të shkojë vetë ka refuzuar që të shkojë, duke nxjerrë arsyeime të ndryshme dhe pikërisht nga këto raste ka lindur konflikti me asistenten znj. Kryeziu, lidhur me shkresat të cilat i janë dërguar për disa sqarime rreth udhëtimit.

Ai tha se z. Staletoviq është ankuar pse shkresa i është dërguar në gjuhën shqipe kurse vërejtjen e tij ai e ka dërguar pikërisht në gjuhën serbe dhe nuk e ka respektuar dygjuhësinë, siç ka pretenduar që të respektohet dhe sipas pohimeve të tij z. Staletoviq ka tentuar që ti përkthehet edhe komunikimi ndërkolegial, gjë që nuk e ka lejuar Avokati i Popullit.

Sa i përket vërejtjes që ka të bëjë me menaxhimin e financave dhe kontrollin e tyre, ai tha se financat i menaxhon drejtori ekzekutiv dhe i kontrollon Auditori i Përgjithshëm. Lidhur me kontrollin e financave, ai theksoi se janë dërguar shume shkresa tek prokuroria themelore dhe ata kanë ngritur hetime në mënyrë anonime, por premtoi se nëse nuk japin informacione rreth qëllimeve të hetimeve, ai nuk do të lejojë që t'i drejtohen Avokatit të Popullit sepse deri më tani të gjitha veprimet kanë qenë joformale sepse shumica e komunikimeve janë bërë me telefon.

Sa i përket pohimeve të z. Staletoviq që në Institucionin e Avokatit të Popullit ka persona që i kryejnë dy apo më tepër punë, ai tha se është shumë e vërtetë, duke dhënë arsyeime se nuk munden që të angazhohen punëtorë të ri për disa punë të vogla të natyrave të ndryshme.

Rreth qasjes në dokumente publike z. Staletoviq ka theksuar fshehjen e dokumenteve, mirëpo Avokati i Popullit e mohoi një gjë të tillë, duke thënë se dokumente të fshehura janë çështjet dhe

të dhënat e ankuesve si dhe dokumentet personale të bashkëpunëtorëve dhe sipas tij në këto dokumente nuk mund të kenë qasje askush e as z. Staletoviq.

Kryetarja, duke u ndërlidhur në bisedë, kërkoi nga Avokati i Popullit që të përmbahet në shprehjet e tij dhe mos të përdorë shprehje fyese.

Sami Kurteshi, tha se bashkëpunëtorët janë me te sepse i ka përmendur vetë zëvendësavokati, sa i përket takimit me EULEX-in në Graçanicë, kam thënë se duhet të jetë Aleksandra Dimitrijeviq dhe Isa Hasani, sepse këta merren me atë çështje profesionale, por në qoftë se z. Staletoviq dëshiron të marrë pjesë gjithkund, duhet të ketë parasysh se i caktoj unë në atë mënyrë që institucioni të jetë i përfaqësuar në mënyrë profesionale dhe këtu ka qenë problem. Raportet janë, dhe ato janë publike pavarësisht se dikujt i pëlqejnë apo jo. Fjalën mobbing për herë të parë e ka përdorur në terminologji z. Arsim Agani, në bashkëpunim me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, që rastësisht e kanë gjetur në Google dhe e kanë përkthyer, dhe këtë e kanë përdorur z. Staletoviq dhe z. Agani, që në përkthim të drejtë do të thotë shantazhim, kërcënim i njerëzve edhe nga pozitat e ulëta edhe nga pozitat e larta. Veprimet e z. Agani dhe Staletoviq ndaj bashkëpunëtorëve të tyre janë formë klasike e Mobingut, dhe në këtë fjalë s'e përdorim sepse nuk është terminologji e jona.

Sa i përket rastit, Agani tha se do të flas z. Isa Hasani, i cili ndjek vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, por tha se mund të ju them se z. Agani ka kryer një punë shumë të keqe në institucion dhe e ka keqinformuar opinionin publik duke i fshehur dokumentet.

z. Staletoviq ka cek se nuk i paguhet reprezentacioni, nuk i jepet vetura, edhe pse kjo rregullohet me ligj dhe rregullore, dhe as me ligj e as me rregullore nuk parashihet ardhja dhe shkuarja në punë, por ne ja kemi lejuar z. Staletoviq me e përdorur veturën për shkak të rrethanave që kanë ekzistuar. Reprezentacionin ia kemi ndërpre për shkak të punëve që i ka bërë z. Staletoviq, është cekur nga z. Staletoviq se ka bërë punë të administratës, ka qenë i thirrur me udhëheqje Departamentin e Diskriminimit që ia ka caktuar Avokati i Popullit, e të cilën punë nuk e ka bërë, e jo të bëjë punë të administratës. Ndërsa, sa i përket takimit në Ohër, që e ka përmendur Staletoviq, ka shkuar Ibrahim Arslan, ndërsa Staletoviq nuk ka shkuar. Kanë qenë të njëjtat rrethana, të njëjtat probleme por z. Staletoviq nuk ka shkuar, dhe nëse z. Staletoviq vazhdon ta kryej këtë detyrë, më nuk ka me e përfaqësua institucionin askund nëpër vizita, sepse ja jep detyrën dhe nuk e kryen, sepse nuk ka aftësi profesionale.

Sa i përket materialit që është dërguar me fushnotë, z. Jashari tha se 99% e fushnotave janë letra të z. Staletoviq, që ai i ka dërguar dhe është thirr në vetveten.

Pastaj ai tha se e ka përmendur fjalën racizëm dhe nuk i kam thënë askujt raciste, por se ka thënë se mënyra e përdorimit të fjalës ka racizëm.

Sami Kurteshi, tha se shumica e pushtimeve në botë nga shtetet e mëdha të shteteve të vogla, ka ndodhur në emër të civilizimit.

Biserka Kostiq, tha se konstatoj edhe pse jeni demagog i mirë por nuk e njihni mirë terminologjinë e huaj. Unë njoh mirë termin jociivilizues dhe racizëm, që mes tjerash në termin civilizim dhe jociivilizim eksiton përkatësia racore. Unë nuk e tërheq fjalën në atë se çka kam thënë. Juve nuk ju ka hije si njeri i parë i një institucioni, ndaj meje si deputete të thoni se ka kaluar koha e Jugosllavisë. Ju me herët thatë se duhet te kryhet puna, të gjithë duhet te jemi te barabartë, dhe ju është besuar ky funksion në këtë institucion dhe duhet të jeni të parët në mes të

barabartëve, dhe konstatimi tjetër është se ju dëshironi të konstatoni kualifikimin profesional edhe te zëvendësit tuaj, do të thoni se ne kemi bere lëshime kur kemi bere përzgjedhjen e tyre kur janë lajmëruar me konkurs për vendin e zëvendësve të Avokatit të Popullit. Mund pra të formoni komisionin dhe të merreni me këto çështje, në mënyrë profesionale dhe kualifikimeve të të gjithë personave dhe jo vetëm të një personi. Ju e keni quajtur z. Staletoviq shovinist, kush ju ka dhënë juve te drejtën dhe këtë kompetencë dhe e quani idiot. E akuzoni për mosnjohje të gjuhëve të huaja, është e drejtë e imja të flas në gjuhën serbe dhe e kam të garantuar me Kushtetutë, nuk mund të akuzoni nëse shkoj në udhëtime zyrtare dhe nuk flas gjuhë të huaj sepse sipas detyrës zyrtare, atij i takon përkthyesi, ju edhe bashkëmendimtarin e tij Aganin e quani shovinist, e pse ai është shovinist? Unë vetëm po ju citoj juve, ka shkuar të vizitojë familjet serbe të arrestuarve në Partesh, çka ka te keqe në këtë rast, ka treguar për gjendjen që e ka gjetur, ka mandatin të shikojë faktet reale.

Kryetarja, tha se debatin duhet ta vazhdojmë në mënyrën më të mirë të mundshme dhe me mirëkuptim, duke kontribuar për një zgjidhje më të mirë.

Biserka Kostiq, pyeti Avokatin e Popullit se a është ky raporti i tij profesional.

Sami Kurteshi, tha se sa i përket verifikimit të diplomave, mendoj se është mirë të bëhet një gjë e tillë. Unë sipas ligjit nuk jam i pari në mesin e të barabartëve me funksion. Sipas ligjit, unë jam i pari, institucioni i Avokatit të Popullit është institucion monokratit e ka një udhëheqës, i cili merr përgjegjësi. Kjo është me ligj, kur ta ndryshoni ligjin atëherë mund të bëni ndryshime sepse e përcakton ligji. Sa i përket gjuhës, unë nuk kam thënë, fole gjuhen shqipe, por se në takimet ndërkombëtare nuk mund ta dërgojmë sepse nuk e flet ndonjë gjuhë të huaj dhe për kontakte duhet t'ia dërgojmë një përkthyes, i cili kushton dhe nuk kemi mundësi. Në si institucion kemi njerëz të cilët komunikojnë pa përkthyes dhe nuk ka nevojë sigurimin e përkthyesve, ndërsa se a flisni ju gjuhen serbe apo jo, unë asgjë s'ju thash, po kur ju ta flisni gjuhen e juaj pranoni edhe tjetrin ta flas gjuhen e vet amtare. Z. Staletoviq është drejtuar në gjuhen e vet, ndërsa kur dikush ju ka përgjigj po në gjuhen e vet amtare, atëherë ja ka treguar nenet e Kushtetutës, e kjo atëherë është jociivilizuese dhe e padrejtë. Raporti i Institucionit të Avokatit të Popullit është profesional, në krejt atë çka benë ky institucion dhe sa janë njerëzit e tij profesionalë, ky raport është botuar, mendoj se është profesional dhe i përgjigjet plotësisht dhe është pak më profesional se përgatitja e njerëzve që kemi në institucion.

Kryetarja, tha se prej debatit që dëgjuam po vërehet se ka mosmarrëveshje mes juve dhe ne për këtë ju kemi thirrur këtu, që të dëgjojmë vërejtjet e të dy palëve, por ne jemi për atë se ju ti zgjidhni këto dhe te bashkëpunoni në mënyrën më të mirë të mundshme sepse është për të mirën dhe funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit. Ndërsa sa i përket rastit të z. Arsim Agani, ajo tha se ka vetëm një pyetje: pse nuk e respektoni vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, derisa e dimë që procedura gjyqësore nuk e ndalon ekzekutimin e atij vendimi.

Rita Hajzeraj, tha se e kemi pranuar se ligji për Avokatin e Popullit ka mangësi. Ne kemi bërë edhe monitorimin e Ligjit për Avokatin e Popullit, sa i përket përzgjedhjes së zëvendësavokatëve të Popullit Ne e kemi bërë klasifikimin e dokumentacionit, por avokati e ka zhvilluar intervistimin dhe ka bërë përzgjedhjen e tyre. Ndërsa, neni 12, i ligjit parasheh edhe procedurat e

shkarkimit të Avokatit dhe zëvendësve të tij, dhe mund të paraqes kërkesë në Kuvendin e Kosovës për shkarkimin e tij. Ajo tha se nëse ka mosmarrëveshje të tilla, ta shfrytëzoni kompetencën e juaj që e keni me ligj.

Kryetarja, tha se nuk e kemi bërë këtë ballafaqim për të shkarkuar askënd, por për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mënyrën më të mirë, sepse nuk do të thotë që si të parqet dikush një ankesë, menjëherë të sanksionohet dhe të shkarkohet. Ne jemi vetëm që të kemi marrëveshje.

Sami Kurteshi, tha se procedura e zgjedhjes se zëvendësve të Avokatit të Popullit, ka qenë në këtë mënyrë, Avokati i Popullit i ka propozuar, ndërsa i ka zgjedh Kuvendi. Ai tha se në institucion puna shkon shumë mirë, por kemi persona që janë të interesuar të bëjnë probleme dhe janë persona te caktuar. Ne nuk e kemi bërë kërkesën për shkarkim për arsye se mund të shkohet në këtë mënyrë dhe po tregohet se kush nuk mund të durojë punën, por kërkoj nga Kuvendi që mos të përjashtohet mundësia e kërkesës për shkarkim të z. Staletoviq, sepse nuk jemi ne që kemi sjell punën këtu ku jemi, por atë e ka hapur vet z. Staletoviq dhe atëherë shkojmë deri në fund.

Kryetarja, tha se meqë u tha se Isa Hasani është me kompetent të flas për rastin e z. Agani, atëherë po bëjë pyetje pse se respektoni vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, dhe të kthehet Agani në vendin e punës.

Isa Hasani, tha se do të sqarojmë rreth moszbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i ka marrë dy vendime lidhur me z. Agani, një vendim për masën disiplinore të komisionit, largimin nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër, ndalim gradimi deri në 5 vjet. Këtë vendim e ka vërtetu Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, kur e ka marr këtë vendim z. Agani ka qenë i pakënaqur dhe ka bërë një kërcënim që komisioni e ka vërtetu dhe ja ka ndërpre marrëdhënien e punës dhe në procedurën e animimit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, ia ka anuluar vendimin e institucionit të Avokatit të Popullit, dhe e kthen në punë, në detyrën e pozitës së drejtorit të administratës, tash ne i kemi dy pozita juridike të z. Agani; një largim nga zyra dhe transferim që është i plotfuqishëm dhe e ka vërtetu vetë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës dhe tjetrin që e kthen në detyrën e drejtorit të administratës, pa e anuluar vendimin e parë. Dhe, tani i kemi dy vendime të plotfuqishme të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës dhe cili të zbatohet. Vendimin e fundit e kemi ankimuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kemi bërë padi dhe kërkesë për pezullimin e vendimit. Gjykata në afat ligjor ka marr vendim lidhur me kërkesën për pezullim të vendimit dhe ka thënë që kërkesa duhet të drejtohet në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, si organ i shkallës së parë që e ka nxjerr atë vendim për ta pezulluar ata vendimin. Ne kemi bërë kërkesën për pezullim edhe në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, edhe ata e kanë shkel ligjin, nuk e kanë respektuar ligjin për konflikte administrative. Pastaj z. Agani ka filluar procedurën për ekzekutimin në gjykatë. Gjykata ka marrë një aktvendim për lejimin e përmbarimit, mirëpo, ne në bazë të ligjit për procedurën përmbarimore, e kemi bere një prapësim dhe tash jemi në pritje të procedurës në gjykatë. Z. Agani në komision e ka marrë një rekomandim e edhe ne e kemi marrë të njëjtin dhe kemi ardhur në një pozitë të palakueshme. E di se ju nuk i keni pasur këto informata që unë ua dhashë këtu se vendimi ende nuk është ende i formës së prerë dhe është në procedurë të ankimimit, në mungesë që pala nuk ju ka dhënë juve informacione dokumentet, ju keni nxjerrë një rekomandim që na ka shkaktuar pak dëm sepse është keqpërdorur, ka shkuar në

polici, në Gjykatë dhe ka dal dy herë në media se Avokati i Popullit nuk e zbaton rekomandimin e Kuvendit.

Rita Hajzeraj- tha se neni 14 dhe 15, i Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, thotë se institucionet duhet ti respektojnë vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, pa marr parasysht sepse vendimi i fundit është valid dhe vetvetiu e shfuqizon vendimin paraprak, dhe pse nuk e keni marrë ta respektoni këtë vendim deri sa të del vendimi gjyqësor dhe atëherë të respektohet vendimi gjyqësor.

Sami Kurteshi, tha se në qoftë se kemi dy vendime të plotfuqishme, kemi paradoks ligjor dhe kjo shkakton një çështje, vdekjen e institucionit, dhe këtë paradoks ligjor duhet ta sqaroj Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, për rregullimin e çështjes më nuk ka mbetur rrugë tjetër veçse vendimi i gjykatës dhe ai vendim është i plotfuqishëm.

Kurtan Kajtazi, tha se nuk ka arsytim rreth moszbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, nuk është respektuar as vendimi i parë e as i dyti dhe nuk dijë se si arsyetoheni në raport për vendimet e tjera të institucioneve tjera që ta respektojnë vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Këtu po vërehet një çështje përplasjesh mes jush sepse këtë e ka potencuar ai vet kur ka qenë prezent. Po ta kishte vullnetin avokati i Popullit, kjo çështje do të mund të zgjidhej brenda ditës, por po shihet se vullneti mungon, ndërsa ka qenë mirë që në takimet tona që kemi pasur, Avokati i Popullit të na i paraqiste shqetësimet që i ka pasur me zëvendësavokatin e Popullit. Është mirë të gjendet kompromisi dhe të vazhdoj puna si duhet, ndërsa fjalori i juaj duhet të jetë krejt tjetër fare sepse jeni një njeri i një institucioni më të respektueshëm.

Sami Kurteshi, tha se sa i përket rastit Agani, po ju them se duhet tash të pritët vendimi i gjykatës. Ne kërkojmë nga institucionet tjera respektimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës se ato vendime që kërkojmë të zbatohen, nuk janë ankimuar dhe janë të plotfuqishme, e nëse e pranon nuk e ankimon, atëherë zbatoje.

Kymete Bajraktari, tha se nga këto çka i dëgjoj në këtë takim, po dalin dy të vërteta dhe kjo është një gjë shumë e hidhur sepse edhe Avokati edhe z. Staletoviq, po i paraqesin argumentet e tyre, mirëpo, assesi nuk po mundem ta kuptoj Avokatin e Popullit, se si i ka toleruar gjithë këto lëshime në institucionin e tij. Për mu janë të papranueshme, nëse janë bërë këto shkelje dhe nuk është ndërmarre asgjë deri më tani.

Bogoljub Staletoviq, tha se kam ardhur në komisionin e juaj nga një shkak i thjeshtë, i thirrur në padrejtësitë e diskriminimit që bëhen ndaj meje në këtë institucion. Më vjen mirë që e thatë ju në fillim të këtij takimi, që kjo të përmbillet në mënyrë të dinjitetshme dhe gjërave që kanë ndodhur me vite të tëra, t'u vihet pika. Ne nuk kishim asnjë respektim të drejtave të mia, ato shkeleshin e them se kishte shkelje edhe nga ana ime, por ne punojmë për institucionin, unë kam tentuar që me një ton të qet të them atë se çka po përjetoj. Ju e vërejtët se si sillet z. Avokat ndaj meje, pse nuk kam mundur të kryej një numër të rasteve, dhe kemi lëshime, por lëshimet janë më të mëdha nga ana e Avokatit të Popullit, se sa nga ana e ime si zëvendësavokat. Nga ana e tij është forca, ka mbrapa vetes njerëz që e mbështesin jashtëzakonisht fort, dhe ka një selektim që nuk është në pyetje profesionalizmi apo jo, ky është problemi me i vogël. Kemi kaluar disa fakte që nuk janë argumentuar, por unë gjithmonë kërkoj që të emërohet një asistent ekzekutiv dhe jo sekretarëshë

dhe ka raste kur nënshkruhen akte me emër dhe mbiemër pa pozitë. Kam insistuar që çdo punëtorë të ketë edhe titullin dhe përgjegjësitë në çka është emëruar. Prandaj, do t'ju lutesha juve kam tërhequr vëmendjen për shume gjëra. Ju e dëgjuat diskutimin, çështjen e raporteve, si të hartohen raportet, kur jam unë i përjashtuar nga të gjitha marrëdhëniet e nivelit që duhet të mbahen në institucion. Ju jeni dëshmitarë se çfarë fjalësh mu thanë, dhe se këtë gjë e përjetoj edhe në institucion, ky është vetëm një imazh i përsëritur.

Sami Kurteshi, tha se edhe njëherë kërkon nga zëvendësavokati që të dëshmon se vetëm njëherë i është shkelur një e drejtë, se vetëm njëherë e ka fyer dikush në çfarëdo forme, të dëshmon se cilin informacion që silltet në institucion nuk e ka, të tregon se kush ka privilegje në këtë institucion, dhe tani kemi mu barazua me të gjitha, pse i kam duruar të gjitha këto deri tash, i kam durua vetëm mos të bëhet kjo punë e madhe në institucion, dhe se puna ka ecur në institucion në mënyrën e duhur edhe pse një njeri nuk ka punua.

Kryetarja, tha se nuk jemi gjykatë për të vlerësuar se qëndrimet e kujt janë të drejta, të Avokatit të Popullit apo të zëvendësavokatit. I kishim lutur të dy palët që të gjejnë mirëkuptim dhe të tejkalojnë këtë situatë, për të mirën e Institucionit.

Ajo tha se po fillojmë sa i përket raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012. Komisioni e ka shqyrtuar edhe me pare dhe kemi dhënë disa vërejtje. Ju i keni bërë disa përmirësime, por jo të gjitha ato që ne i kemi diskutuar. Nuk jemi ne ata që ju mësojmë si të punohet raporti, por për mospërfshirjen e tyre, duhet të na sqaroni. Ajo tha se të diskriminimi kisha vërejtje dhe nuk ishte përfshirë prapë. Ju i keni bërë disa përmirësime që i kemi cekur ne dhe disa i keni bërë vet. Në fund krejt, kanë munguar disa rekomandime të cilat është dashur të jepen. Ju vetëm e keni shtypur raportin. Ka pasur vërejtje edhe nga anëtarja e Komisionit, Albana dhe vërejtjet e saj, nuk janë përfshirë në raport. Kanë qenë për personat e pagjetur, liria e lëvizjes, pra kanë qenë disa vërejtje nga komisioni dhe në mbledhjen e fundit që kemi pasur ka qenë një situatë kur anëtarët e komisionit kanë deklaruar se ishin për abstenime dhe për mos marrë një vendim me abstenime, kemi kërkuar që për një javë mos të miratohet raporti dhe t'ju kërkojmë që t'i vlerësoni ato propozime që i kemi bërë, se a do t'i inkorporoni apo jo në raport.

Sami Kurteshi, tha se atë ditë kur u shqyrtua raporti në komision, unë i kam marrë vërejtjet të gjitha në origjinal dhe i kam këtui. Tani e kam raportin me përmirësime, edhe atë ditë kam thënë se për të gjitha vërejtjet, për të cilat jemi pajtuar, do të bëhen ndryshime, për ato që kemi dhënë shpjegime, kemi thënë janë shpjegime. Nuk mund të ndryshojmë ato dhe shtoi se i ka të gjitha pyetjet e deputetes Albana, deputetes Suzana, deputetes Biserka dhe deputetes Kymete.

Kurtani Kajtazi, tha se pjesa e diskriminimit nuk është plotësuar, raporti është shumë i mangët dhe nuk është dashur të shtypet pa u miratuar.

Sami Kurteshi, tha se raportin e institucionit nuk e miraton Kuvendi, institucioni i paraqet Kuvendit një raport vjetor për të drejtat e njeriut dhe e njofton Kuvendin me gjendjen të cilën ai e ka fotografuar, formën e ndërtimit të raportit nuk e cakton Kuvendi, por e cakton Avokati i Popullit. Kjo është forma që punojmë që 4 vjet. Ne mendojmë se raporti nuk është i punuar ashtu siç duam ne dhe kjo më mundon më së shumti. Ne kemi bërë edhe raporte të veçanta siç është raporti për gjendjen në burgje, që këtu nuk është i përfshirë. Kemi botuar edhe një raport për shfrytëzimin seksual të fëmijëve.

Biserka Kostiq, tha se ka pasur vërejtje në çështjen e të pagjeturve dhe kjo nuk është përfshirë në raport, cilat janë kompetencat e Institucionit për këtë çështje.

Sami Kurteshi, tha se çështja e të zhdukurve është e rregulluar me ligj që e ka miratuar Kuvendi i Kosovës dhe kjo çështje nuk është kompetencë e Avokatit të Popullit. Ne si institucion, kemi të drejtë t'i trajtojmë rastet deri në 6 muaj të vjetra. Në rastet kur konstaton se ka shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut, kemi të drejtë të marrim ndonjë rast, mund ti ndihmojmë ndonjë shoqate apo individ, nëse vjen në institucionin e Avokatit të Popullit. Institucionet publike, përgjegjëse për çështjen e të zhdukurve, nuk po merren me çështjen tonë, dhe mendojmë se kjo është një shkelje, por ne nuk merremi me çështjen e të zhdukurve, nuk kemi kompetencë,

Biserka Kogstiq, tha se ne raporte ka vërejtur se paraardhësit e juaj janë marrë me çështjen e të zhdukurve, dhe kam menduar që edhe ju jeni kompetent, që në raportin tuaj të ofroni opinionin e Institucionit tuaj, a i përket informatave adekuate nga institucionet dhe në baze të ligjit, i cili obligon institucionet, duhet të merren me zgjidhjen e kësaj çështje, dhe kjo është një çështje shumë e ndjeshme, duke u nisur nga kjo, kemi konsideruar se edhe në këtë raport është dashur të përfshihet kjo çështje, meqë është mjaft e ndjeshme.

Sami Kurteshi, bëri pyetje se për cilin raport është fjala, prej vitit 2009 e me përpara, raportet janë punuar me ligje tjera. Prej viti 2010, raportet punohen në harmoni me Ligjin për Avokatin e Popullit, nuk merremi me këtë çështje vetëm se kemi pengesa ligjore, nuk kemi pengesa të tjera.

Rita Hajzeraj, tha se Institucioni i Avokatit të Popullit ka të drejtë të bëjë raportin ashtu siç i kanë kompetencat, por tendenca jonë është, që kur te vjen raporti në seancë plenare, si komision me qenë ata që e mbrojmë këtë raport e jo që e kritikojmë. Unë jam që raporti të miratohet me këto ndryshime që janë bërë, mos të vonohet më tepër.

Kurtan Kajtazi, tha se ky raport është dashur të jetë me i thellë, më i përpiktë, në disa raste përpilimi i raportit është i bartur prej viteve në vite. Mua me shqetëson gjuha politike e Avokatit të Popullit dhe tha se është për ta kaluar raportin në Kuvend, kush ka vërejtje le ti paraqet në Kuvend.

Kryetarja, tha se në media thuhet se 200 raste janë përmbyll për shkak të asaj se kur janë thirrur në telefon nuk janë lajmëruar a është e vërtetë kjo?

Sami Kurteshi, tha se kjo ka qenë në gazetën "Koha Ditore", cila përmes personave anonim që ne nuk po i dimë, e ka marrë e dhe e ka botuar një procesverbal të një mbledhje të Institucionit të Avokatit të Popullit. Unë kam thënë nuk ka arsye të mbahen raste të hapura, gazeta ka shkruar krejt padrejtë, në institucion i kemi 2000 raste dhe nëse fillon secili kur ka dëshirë me hap dhe me mbyll rastin, bëhet katastrofë. Unë nuk merrem me raste individuale, por kam të drejtë t'i mbikëqyr se çka është duke ndodhur, dhe ato që janë shkruar në gazetë nuk janë të vërteta sepse ne bëjmë verifikimin e çdo rasti veç e veç,

Biserka Kostiq, tha se sa i përket raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit, do të abstenoj, sepse konsideroj se së pari raporti nuk është i kompletuar dhe se nuk janë respektuar

anëtarët e komisionit dhe kërkesat e tyre reale për vërejtjet e tyre për tu plotësuar raporti. Nën dy, konsideroj se diskriminimi më i madh i shekullit 21, është çështja e personave të zhdukur dhe kjo është kompetencë e tij, dhe për respektin që kemi ndaj familjeve të tyre, konsideroj se Avokati i Popullit është dashur me i përfshi në raport.

Komisioni pas një debati të gjatë, me 5 vota për dhe një abstenim nga Biserka Kostiq, nxori këtë:

Përfundim

Raport vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2012, me ndryshimet e bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit, të procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali